



| | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Planuar / Dorezuar Pit mijena/Prodato Received/Delivery | | 24.06.2022 | 2 viti god year |
| Organ./Njesia Organ./Jedrnica Org./Unit | Nr Prot Bz Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKOPSICK | 3705/2022 | | 1/4 |



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.468/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Jeton Koca anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.468/2022 të datës 19.05.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë/MBPZHR, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar Ankesa me numër A.nr.468/2022 e datës 13.05.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet ne fuqi Vendimi me nr. 1853 i datës 05/05/2022 i Menaxheres së Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

A r s y e t i m

Ankuesi ne datë 29.04.2022 ka aplikuar në konkursin e shpallur për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Inspektor i Tokës Bujqësore me numër reference RN00038559 në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë/MBPZHR.

Menaxherja e Burimeve Njerëzore, në fazën e shqyrtimit paraprak të aplikacioneve, me Vendimin numër 1853 të datës 05.05.2022 ka refuzuar aplikacionin e ankuesit me arsyetimin se i njëjti nuk i ka plotësuar kushtet për lëvizje brenda kategorisë për pozitën përkatëse të punës, pasi që ankuesi nuk posedon arsimin e kërkuar (diplomë të studimeve master) dhe rrjedhimisht i njëjti nuk është përfshirë në listën e shkurtër të kandidatëve.

Kundër vendimit për refuzimin e aplikacionit, ankuesi me datë 10.05.2022 ka parashtruar ankesë të Njësia për Burime Njerëzore e Thesarit të Kosovës. Kjo e fundit me Vendimin me numër 1966 të datës 13.05.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Ankuesi me datën 19.05.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2922/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër vendimit me numër 1966 të datës 13.05.2022 të Menaxheres së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 27.05.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë/MBPZHR, ndërsa kjo e fundit me datë 07.06.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 3314/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e vendimmarrjes, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2922/2022 të datës 13.05.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e konkursit e shpallur me datën 21.04.2022 deri më datën 30.04.2022; vendimi i datës 05.05.2022 me nr.1853 për refuzimin e aplikacionit; Përfundimi i verifikimit paraprak i datës 05.05.2022; Ankesa e datës 10.05.2022 e parashtruar për Menaxheren e Burimeve Njerëzore; Diploma e datës 26.03.2012 e lëshuar nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë me nr.150 në Universitetin e Prishtinës; Pasqyra e notave në drejtimin master e datës 29.04.2022 e lëshuar nga Fakulteti i Bujqësisë; Vendimi i datës 13.05.2022 me nr.1966 i nxjerr nga Menaxherja e Personelit; Përfundimi i i procedurës për lëvizje brenda kategorisë i datës 13.05.2022 me nr.1981; Përgjigje në ankesë e datës 27.06.2022 nga organi i punësimit me numër protokollit 3314/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Aplikacioni i datës 29.04.2022 për Kopja e letërnjoftimit; Diploma e datës 26.03.2012 e lëshuar nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë me nr.150 në Universitetin e Prishtinës; Diploma e datës 26.03.2012 e lëshuar nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë me nr.150 në Universitetin e Prishtinës; Çertifikatë e datës 10.06.2016; Rekomandim i datës 25.05.2012; Rekomandim i datës 03.01.2014; Çertifikatë e datës 03.02.2015; Letër reference e datës 25.06.2019; Vërtetim i datës 25.06.2019; Akt emërimi i datës 01.08.2020; Vlerësimi i rezultateve në punë i datës 30.12.2021 dhe Njoftim për masë disiplinore e datës 28.04.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar së më datë 05.04.2022 në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) është shpallur njoftimi lidhur me hapjen e konkursit për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës "Inspektor i tokës bujqësore" me

numër reference RN00008559, në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë/MBPZHR. Konkursi në fjalë ka qenë i hapur nga data 21.04.2022 deri me datë 30.04.2022, dhe si kritere të përgjithshme formale kanë qenë të përcaktuara:

Arsimi i kërkuar: Diploma e studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. Diplomën Master të jetë e njëjte apo vazhdim i diplomës Bachelor, Fakulteti i Bujqësisë dhe Fakulteti Ekonomik

Përvoja e punës: së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lire të punës.

Sipas shkresave të lëndës rezultojnë se ankuesi me datë 29.04.2022 ka aplikuar në konkursin e shpallur për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës "Inspektor i Tokës Bujqësore" me numër reference RN00008559 në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë/MBPZHR, mirëpo Menaxherja e Burimeve Njerëzore, në fazën e shqyrtimit paraprak të aplikacioneve, me Vendimin numër 1853 të datës 05.05.2022 ka refuzuar aplikacionin e ankuesit me arsyetimin se i njëjti nuk ka plotësuar kushtet për lëvizje brenda kategorisë për pozitën përkatëse të punës, pasi që ankuesi nuk posedon arsimin e kërkuar (diplomë të studimeve master) dhe i njëjti nuk është përfshirë në listën e shkurtër. Rrjedhimisht ankuesit me bazë të njëjte i është refuzuar edhe ankesa e parashtruar kundër vendimit për refuzimin e aplikacionit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se i është bërë e pa drejtë nga Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e refuzimit të aplikacionit për pozitën e punës "Inspektor i Tokës Bujqësore" sepse i njëjti pretendon se i ka plotësuar kriteret e konkursit dhe për këtë ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme si pasqyrën e notave master të lëshuar nga Fakulteti i Bujqësisë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" të datës 29.04.2022 me nr.04-394.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka shqyrtuar shkresat e lëndës një nga një dhe rrjedhimisht ka konstatuar se ankuesi ka përfunduar studimet themelore me datë 30.09.2011 dhe ka marrë titullin Bachelor i Agroekonomisë me gjithsej 180 kredi/ECTS, dhe kjo është vërtetuar përmes Diplomës me numër 150 të datës 26.03.2012 të lëshuar nga Fakulteti i Bujqësisë-Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina". Ndërsa lidhur me përfundimin e studimeve master ankuesi me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës, ka dorëzuar vetëm pasqyrën e notave të studimeve master.

Kolegji vlerëson se pasqyra e notave të studimeve master i dorëzuar me rastin e aplikimit, mund të shërbejë si dëshmi për nevojën e brendshme të Fakultetit, gjegjësisht Universitetit, por jo edhe për nevojën e punësimit, sepse me dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës, përkatësisht nenin 135 përcaktohet se: *Përfundimi i suksesshëm i studimeve në përputhje me programin e studimeve vërtetohet nga Universiteti përmes diplomës që është dokument zyrtar.*

Ankuesi me rastin e parashtrimit të ankesës i është referuar dokumentit, pasqyrës së notave të datës 29.04.2022 me nr.04-394 të lëshuar nga Fakulteti i Bujqësisë pranë Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", dhe pretendon se ky dokument ka qenë dëshmi e mjaftueshme përmes të cilave vërtetohet përfundimi i studimeve master.

Andaj, bazuar si me sipër Kolegji vlerëson se ankuesi me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës, ku afati i aplikimit ishte nga data 21.04.2022 deri me datë 30.04.2022 nuk ka sjellë dëshmi të duhura për vërtetimin e përfundimit të studimeve master, nga autoriteti kompetent, në këtë rast Universiteti i Prishtinës, dhe në këtë mënyrë nuk ka plotësuar kriterin e konkursit lidhur me arsimimin, ku përcaktohej: *Arsimi i kërkuar: Diploma e studimeve universitare në Fakultetin e Bujqësisë dhe Fakultetin Ekonomik, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. Diploma Master të jetë e njëjte apo vazhdim i diplomës Bachelor.* Në këtë kuptim Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të paqëndrueshme dhe rrjedhimisht vlerëson se Njësia për Burime Njerëzore, me rastin e nxjerrjes së Vendimit nr.1853 të datës 05.05.2022 për refuzimin e aplikacionit të ankuesit dhe Vendimin me numër 1966 të datës 13.05.2022 për refuzimin e ankesës si të pa bazuar ka vërtetuar drejte dhe në mënyrë të plote gjendjen faktike dhe rrjedhimisht drejte ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-144 për Zyratet Publikë, dhe Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.468/2022, datë 24/06/2022

Sabile Avdyli

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryeshefit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

